

Në përputhje me autorizimin e dhënë me nenin 17.b të Ligjit për Bankën Qëndrore të Republikës së Kosovës dhe nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/25 të datës 5 tetor 2001 mbi licensimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e veprimtarisë së kompanive të sigurimit dhe të ndërmjetësuesve të sigurimit,

Me qëllim të zbatimit të nenit 6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25, Bordi Drejtues i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2008, miratoi si në vijim:

**Rregulla 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të
Autopërgjegjesisë
Neni 1**

Kushtet e përgjithshme dhe rregullimi

1.1 Autoriteti ligjor

Kjo rregull përcakton sigurimin e detyrueshëm të përgjegjesisë për dëmet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i automjeteve (me tutje: sigurimi i autopërgjegjesisë), që parashihet me nenin 6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/25 mbi licensimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e veprimtarisë së kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësve të sigurimit (me tutje “Rregullore e Sigurimit”).

Kjo rregull është bazuar në nenin 3.3 të Rregullores së sigurimit dhe autorizon BQK-në që të përcaktojë rregulla, urdhëra dhe udhëzime të nevojshme për drejtimin e sigurimit në përgjithësi, si kushtet e përbashkëta të polisës dhe kërkesat për premi për ofrimin e sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjesisë.

1.2 Sfera e zbatimit dhe qëllimi i rregullës

Kjo rregull zbatohet për të gjitha kompanitë e sigurimit që ofrojnë sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë.

Qëllimet e kësaj rregulle janë:

Te përcaktojë kushtet e polisës që ofron sigurim të detyrueshëm të autopërgjegjesisë.

Te përcaktojë kërkesat për udhëheqjen e biznesit të kompanive të sigurimit që kanë të bëjnë me sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë

Te organizoje dhe të themeloje fondin garantues për dëmet e përfshira në kërkesat e sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjesisë.

Të vendosë standardet e adoptuara nga BQK-ja, sipas të cilave tarifat për premitë e sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjesisë janë të drejta, adekuate dhe jodiskriminuese.

Të rregullojë qështje të tjera me rëndësi për zhvillimin e biznesit të sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjesisë.

1.3 Përgjegjësitë e BQK-se

BQK-ja do t'i përcaktojë kushtet dhe rregullat e punës për kompanitë që merren me sigurimin e detyrueshëm dhe njëkohësisht do të bëjë mbikëqyrjen e kësaj pune.

Kompanitë e sigurimit janë të detyruara që paraprakisht të parashtrtojnë për miratim nga BQK-ja kushtet e polises dhe tarifat e premive për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë. Para aprovimit të formës së polisës dhe premise, BQK-ja duhet t'i përmbahet nenit 58.1 të Rregullorës së sigurimit. Te gjitha format e polisave dhe tarifat, duke përfshirë sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë duhet të miratohen nga BQK-ja.

Polisa për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë mund të lëshohet vetëm përmes sistemit "on-line" dhe pagesa e primit për polisen e sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjesisë duhet të bëhet përmes sistemit të pagesave në bankë.

Është e ndaluar që polisa e sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjesisë të lëshohet jashtë sistemit "on-line". Pagesa e primit për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë nuk mund të kryhet në ndonjë formë tjetër përveç sistemit të pagesave përmes bankes.

1.4 Kërkesat - detyrimet për sigurim

Pronarët apo shfrytëzuesit e regjistruar të automjeteve, të cilëve u referohen dispozitat e kësaj rregulle në lidhje me sigurimin e detyrueshëm, duhet të kontraktojnë, përkatësisht të posedojnë sigurimin e detyrueshëm valid me kompanitë e licensuara të sigurimit.

Sigurimi i autopërgjegjesisë është i detyrueshëm për pronarët dhe shfrytëzuesit e automjeteve të destinuara për transportin e personave dhe mallrave, rimorkiove, automjeteve të punës dhe traktorëve, të cilët sipas dispozitave për regjistrimin e automjeteve duhet të marrin licencën (lejen e qarkullimit) për trafik. Ky sigurim nuk është i detyruar për KFOR-in.

Mjetet motorrike me targa regjistrimi UN, EU, OSCE dhe CD (Diplomatike) janë të pranuar si të mbuluara me sigurimin TPL dhe duhet të posedojnë dëshminë e polisës valide të sigurimit.

Sigurimi i autopërgjegjesisë kontrahohet për periudhën kohore minimale të mbulesës një (1) vit para se automjeti të hyjë në trafik dhe duhet të ripërtihet për kohën derisa automjeti të shfrytëzohet. Sidoqoftë, në rast të bartjes së pronësisë së automjetit, kontrata mbi sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë mund të jetë për një periudhë më të shkurtur se një (1) vit, në mënyrë që të përputhet me datën e skadimit të regjistrimit të automjetit .

Në rast të likuidimit të një kompanie të sigurimit të licensuar për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë, pronarët apo shfrytëzuesit e regjistruar të automjeteve të siguruara, të cileve u referohet paragrafi i parë i kësaj alineje, duhet që zvendësimin e sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjesisë ta kontrahojnë me kompani të tjera të sigurimit brenda tetë ditësh nga dita kur mbyllja e kompanisë së sigurimit që ka lëshuar sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë është shpallur në media.

Kompania e sigurimit e licensuar dhe e angazhuar në sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë nuk mund të refuzojë kërkesën për sigurim, respektivisht është e detyruar ta kontrahojë sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë sipas kushteve dhe të premive të shpallura të sigurimit.

Nëse kompania e sigurimit konstaton se pronari nuk i përmbush detyrimet nga kontrata e sigurimit, e kjo çënon validitetin e kontratës dhe të vet sigurimit, është e detyruar që lidhur me këtë ta informojë organin e kontrollit të trafikut për t'ia hequr targat e regjistrimit pronarit të automjetit.

1.5 Objekti i sigurimit të detyruar të autopërgjegjesisë

Pronari apo shfrytëzuesi i regjistruar i automjetit dhe rimorkios është i detyruar të kontrahojë sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë nga detyrimet për dëmet e shkaktuara palëve të treta që si kanë pasojë vdekjen, lëndimin trupor, demtimin e shëndetit apo demtimin ose shkatërrimin në lidhje me shfrytëzimin e automjetit motorik.

Sigurimi i detyrueshëm i autopërgjegjesisë gjithashtu duhet të përfshijë detyrimet për dëmet e shkaktuara nga rimorkio e lidhur për automjet apo kur ajo shpërdoret gjatë përdorimit ose derisa ende është në levizje.

Dëmi i shkaktuar nga përdorimi i automjetit, nënkupton edhe dëmet e shkaktuara ndaj palës së tretë nga objektet që bien nga automjeti apo rimorkioja. Me sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë nuk mbulohet dëmi i shkaktuar në mallin e transportuar nga automjeti i siguruar, përveç sendeve që shërbejnë për përdorim personal të udhëtarëve.

Sigurimi i detyrueshëm i autopergjegjesisë nuk e mbulon demin apo detyrimin që është rezultat i veprimeve të natyrës, pasojave të drejtperdrejta të çrregullimeve, detyrimeve nga baza e pergjegjesisë kontraktuese, efekteve të rrezatimit si dhe ngjarje të tjera të ngjashme.

Sigurimi i detyrueshëm i autopergjegjesisë mbulon mbajtësin e polisës së automjetit dhe çdo person tjetër i cili me lejen e mbajtesit të polises vepron dhe shfrytëzon automjetin ose ka qenë i autorizuar prej tij për të vepruar dhe shfrytëzuar automjetin.

Sigurimi i detyrueshem i autopërgjegjesisë mbulon teritorin e Kosovës.

1.6 Bartja e Pronësisë

Kur bartet pronësia e automjetit të siguruar të pronarin e ri, polica ekzistuese e sigurimit nuk do të ketë efekt që nga bartja ligjore e pronësisë dhe anulimit të regjistrimit. Mbajtësi i polices së anuluar mund të kërkojë nga siguruesi kthimin e pjesës proporcionale të premise të pafituar nëse nuk ka pasur zhdëmtim të paguar.

1.7 Dëshmia e sigurimit

Me rastin e përdorimit të automjetit në trafik shoferi është i detyruar të ketë polisën e sigurimit të autopërgjegjesisë apo ndonjë dëshmi tjetër për të provuar sigurimin (“sticker” “Karta identifikuese e sigurimit”) dhe t’ia prezentojë ato policisë së trafikut apo personave të tjerë të autorizuar nga policia.

Në rast aksidenti, shoferi është i detyruar të prezentojë të dhenat personale si dhe informatat relevante në lidhje me sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë të të gjithë pjesëmarrësve në aksidentin e trafikut - të cilët eventualisht do të kenë të drejte kompenzimi të dëmit nga aksidenti në bazë të sigurimit të detyrueshem të autopergjegjesisë.

1.8 Kategoria e “personit të tretë”

Personat në vijim nuk kanë të drejtë zhdëmtimi në bazë të sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjesisë, d.m.th. nuk e kanë statusin e “personit të tretë”.

- a. shoferi përgjegjës për demin,
- b. personi që përvetëson automjetin në mënyrë kundërligjore dhe dëmtohet duke përdorur automjetin e konfiskuar në menyrë të paligjshme .
- c. pronari, bashkëpronari dhe shfrytëzuesit e tjerë të regjistruar të automjetit,në raste se bëhen dëme në pasurinë e tyre.

Neni 2

Shumat e sigurimeve - kufizimi i mbulesës siguroese

Detyrimet e një kompanie të sigurimit që rrjedhin nga sigurimi i detyrueshem i autopërgjegjesisë janë të limituara me shumën minimale të detyruar të sigurimit,e

cila është ne fuqi ne ditën kur ndodh rasti i siguar, në qoftëse nuk është përcaktuar ndonjë shumë më e lartë e mbulesës siguroese në kontrate të sigurimit.

Shuma maksimale e sigurimit te detyrueshëm për një rast të siguar, respektivisht shumat e detyrueshme maksimale të sigurimit, të cilat duhet të kontraktohen në sigurimin e autopërgjegjësise, janë:

a. Për rastin e vdekjes, lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit ;

- për person për autobusë dhe automjete të cilat bartin mallra të rrezikshme
100,000 euro

Shuma totale për autobusë dhe automjete të cilat bartin mallra të rrezikshme
1,000,000 euro

- Për person për të gjitha automjetet e tjera 100,000 euro

Shuma e përmbledhur për të gjitha automjetet 300,000 euro

b. Për rastet e dëmit ne pasuri;

- Për dëm për autobusë dhe automjete të cilat bartin mallëra të rrezikshme
100.000 euro

Shuma totale për autobusët dhe automjetet që bartin mallëra të rrezikshme
200,000 euro

- Për dëm për të gjitha automjetet e tjera 50.000 EURO

- Shuma e përmbledhur për të gjitha automjetet tjera 100,000 EURO

Në rast të aksidentit në të cilin marrin pjesë disa automjete, do te aplikohen shumat e gjithëmbarshme te sigurimit te detyrueshëm te autopergjegjësise në automjetin motorik të perfshirë në të njejtin aksident.

Nëse ekzistojnë disa kërkesa për zhdëmtim dhe zhdëmtimi i gjithmbarshem i tejkalon shumat e siguruara minimale të siguruara të përmendura më lart, të drejtat në zhdëmtim të personave të dëmtuar do të reduktohen në mënyrë proporcionale ndaj kompanisë së sigurimit.

Fondi pensional dhe invalidor, fondi per sigurimin shendetësor si dhe kompanitë e qe merren me sigurime (të detyruara dhe vullnetare) shëndetësore, pensionale apo lloje të ngjashme të sigurimit të jetës, të cilat duhet të paguajn kontribute në pajtim me pensionin e tyre ose kontratat e sigurimit, ndaj aksidentit ,invaliditeit apo sigurimit të pasurise, kanë të drejtë të paraqesin kërkesat e tyre per regresi vetëm pas rregullimit të të gjitha zhdëmtimeve që rrjedhin nga rastet përkatëse të siguruara.

Shumat maksimale të sigurimit sipas paragrafit 1, nëse parashtrohet nevoja, do të përcaktohen dhe ndryshohen nga BQK.

Neni 3

Sigurimi i përgjegjësise së pronarëve dhe shfrytëzuesve të automjeteve për dëmet e shkaktuara palëve të treta

3.1 Dëmet ndaj palëve të treta

Palët e treta të dëmtuara kanë të drejtë t'ia paraqesin kërkesën për zhdëmtim drejtpërdrejt kompanisë së sigurimit.

Nëse i dëmtuari ia parashton kërkesën për zhdëmtim kompanisë së sigurimit, siguruari si përgjegje për një kërkesë të tillë nuk mund të bëjë kundërshtimet, që do të mund t'i bënte ndaj te siguruarit në bazë të ligjit, kontratës dhe kushteve të polisës së sigurimit të detyrueshem te autopërgjegjësia e që i referohen shkeljes dhe mospermbushjes së detyrimeve sipas ligjit apo kontratës që kanë për pasojë humbjen e mbulesës sigurorese.

Kompania e sigurimit e cila e ka paguar zhdëmtimin pa qenë e detyruar ta paguaje ate në bazë të kontratës së sigurimit dhe të kushteve të sigurimit te detyrueshem te autopërgjegjësise, e subrogon te dëmtuarin në relacion me te siguruarin apo çdo person tjetër pergjegjës, për dëmin deri në shumën e zhdemtuar, kamaten dhe shpenzimet.

3.2 Automjetet e regjistruara jashtë Kosovës

Çdo person që hyn në territorin e Kosovës duke ngarë apo duke punuar me automjetin e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të ketë dokument valid ndërkombëtar për sigurimin te autopërgjegjësise nga ato vende me të cilat është arritur marrëveshja bilaterale (Memorandumet e Mirëkuptimit),apo dëshmin për posedimin e polisës së sigurimit vendor të Kosovës, që mbulon dëmet së paku deri në shumën parashkruar ne nenin 2 te kësaj rregulle.

Dokumenti i sigurimit, të cilit i referohet paragrafi 1 i këtij neni, duhet të kërkohet për automjetet që mbahen por nuk përdoren ne Kosove.

3.3 Sigurimi kufitar

Çdo person që nuk ka dëshmi të sigurimit, nga neni 3.2 paragrafi 1 te kesaj rregulle, duhet të lidhë kontratë sigurimi te detyrueshem kufitar të autopërgjegjësise valide për territorin e Kosovës me një kompani vendore të sigurimit të licensuar dhe të autorizuar .

Polisa e sigurimit kufitar nga autopërgjegjësia mund të shitet vetëm sipas marrëveshjes së poolit e cila është e aprovuar nga BQK-ja. Është e ndaluar që

ndonjë kompani sigurimi në mënyrë individuale të shesë polisën e sigurimit kufitar nga autopërgjegjësia.

Mbikëqyrja e përmbushjës së detyrimeve nga vozitësit e automjeteve me targa të huaja sipas këtij neni do të bëhet nga policia.

3.4 Dëmet e shkaktuara nga përdorimi i automjeteve me regjistrim të huaj

Çdo person që është dëmtuar nga përdorimi i automjetit me targa të huaja për të cilin ekziston dokument ndërkombëtar valid i sigurimit apo dëshmia për sigurimin e detyrueshem kufitar të autopërgjegjësive, mund të parashtojë kërkesë për zhdëmtim pranë C.S.O. (Organizata për Trajtimin e Dëmeve Ndërkombëtare) – organizatë e pavarur dhe e specializuar për trajtimin e dëmeve të tilla, e përcaktuar nga BQK-ja, sipas dispozitave të parapara me “Marrëveshjen Unike” të Këshillit të Byrosë (KB).

Trajtimi i dëmeve, të përmendura në paragrafin 1, është në kompetencë ekskluzive të C.S.O., të cilës këto lloje të rasteve të sigurura duhet t’i raportohen. Në të kundërtën, çdo padi e parashtruar nga i dëmtuari kundër të siguruarit ose siguruesit do të konsiderohet si e parakohshme.

C.S.O., me qellim të zhdëmtimit, është e detyruar që të shqyrtoj kërkesën për zhdëmtim brenda afatit prej 60 ditësh, duke llogaritur nga dita e prezentimit të të gjitha provave dhe dokumentacionit relevant për të vendosur përkitazi me përgjegjësin dhe masën e dëmit.

Neni 4 Fondi Garantues

4.1 Dispozitat e Përgjithshme

Fondi garantues duhet të formohet nga kontributet e paguara prej kompanive të sigurimit në pajtim me këto rregull. Parate apo mjetet financiare që perbejne kete fond garantues duhet te depozitohen dhe mbahen në një bankë komerciale të licensuar nga BQK-ja.

Mjetet nga fondi garantues do të përdoren për pagesën e dëmeve të shkaktuara:

- a. Nga përdorimi i automjetit, për të cilin sigurimi i detyrueshem nuk është kontraktuar në pajtim me këtë rregull;
- b. Nga përdorimi i automjetit me targë të huaj, pronari apo shfrytëzuesi i të cilit nuk posedon sigurimin ndërkombëtarë valid apo sigurimin kufitar valid;
- c. Në rast vdekje, lëndimi trupor apo dëmtimi shëndetësor, të shkaktuar nga përdorimi i automjetit të pidentifikuar;

d. Nga përdorimi i automjetit, për të cilin sigurimi i detyrueshëm është kontraktuar me kompani të sigurimit që është në proces të falimentimit;

e. Nga përdorimi i automjetit të përdorur pa autorizim nga personi që ka marrë në posedim në kundërshtim me ligjin dhe rregullat;

f. Nga përdorimi i automjetit për të cilin mbulesa e sigurimit të autopërgjegjësive nuk është në pajtim me mbulesën minimale të sigurimit të detyruar –që zbatohet në Kosovë për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësive në datën e aksidentit.

g. Dëmet/humbjet e shkaktuara nga motoçiklistët e huaj ndaj viktimave në Kosovë të cilat trajtohen nga CSO dhe për të cilat fondi garantues mund të kërkojë kompenzim nga Këshilli i anëtarëve të Zyrës.

4.2 Themelimi i Fondit

Kompanitë e sigurimeve të licencuara për TPL sigurime janë të obliguara që të themelojnë fondin garantues.

Kompanitë e sigurimit duhet të mundësojnë funksionin e fondit garantues drejt vendosjes së detyrimeve të përmendura në nenin 4.1 të kësaj rregulle dhe mbulesën e shpenzimeve të administrimit të fondit, duke participuar në preminë e sigurimit të detyruar të autopërgjegjësive si dhe në shumat e realizuara në bazë të kërkesave të regresit.

Fondi garantues do të udhëhiqet nga Bordi Drejtues, i cili përbëhet nga një përfaqësues nga secila kompani e sigurimit, e cila ofron sigurim të detyrueshëm të autopërgjegjësive si dhe nga ekspertë të dëmeve të emeruar nga Bordi Drejtues. Emërimi i anëtarëve në Bordin Drejtues miratohet paraprakisht nga BQK-ja

4.3 Raporti financiar

Duhet të hartohet raporti i të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe raporti i punës në lidhje me veprimtarinë dhe drejtimin e fondit garantues.

4.4 Kontributet në fondin garantues si dhe të ardhurat teprice

Çdo kompani e sigurimit që ofron sigurim të detyrueshëm të autopërgjegjësive duhet të kontribuojë në fondin garantues në shumën prej 100,000 euro në ditën e parë të muajit të katërt (4) nga data e licensës së saj. Përveç kësaj, brenda ose para pesëmbëdhjetë (15) ditësh të para të çdo muaji duke filluar që nga muaji i pestë (5) nga marrja e licensës, të gjitha kompanitë të cilat ofrojnë sigurim të detyrueshëm të autopërgjegjësive duhet të kontribuojnë me 1% të premive bruto nga polisat e sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësive të lëshuara dhe të ripërtirra gjatë muajit të mëparshëm. Bordi Drejtues duhet të shqyrtojë

rregullisht përshtatëshmërinë e kontributeve si dhe do të rekomandojë tarifa të tjera, të cilat ata i konsiderojnë të arsyeshme për aprovim nga BQK-ja.

Këshilli Drejtues është përgjegjës që të vlerësojë dhe të mbledhë kontributet në fondin garantues. Atij duhet t'i jepet e drejta për vendosjen e kamatës për afatin e kaluar, të cilat norma duhet të jenë të njëjta për të gjitha kompanitë e sigurimit për pagesa të vonuara apo delikuate të kontributit për fondin garantues. Në mbledhjen e kontributeve në fondin garantues, bordi drejtues mund të kërkojë veprim detyrues nga BQK-ja. Shkeljet apo delikuenca në pagesën e kontributit të caktuar përbëjnë bazën për pezullimin apo revokimin e licensës si dhe për denime civile sipas Rregullores së sigurimit.

Çdo tepriçë e të ardhurave në fondin garantues duhet të bartet në vitin e ardhshëm të kontabilitetit dhe të merret parasysh kur percaktohet përqindja e kontributit për vitin (vitet) e ardhshëm të kontabilitetit. Shkalla e kontributeve që e cakton këshilli drejtues vihet në jetë vetëm pas miratimit me shkrim nga BQK-ja.

4.5 Përgjegjësia e kompanisë së sigurimit

Kompanitë e sigurimit nuk kanë përgjegjësi të drejtëpërdrejtë për detyrimet financiare të fondit garantues ndaj palëve të treta. BQK-ja nuk është përgjegjëse për asnjë detyrim të fondit garantues.

4.6 Dëmet e shkaktuara nga përdorimi i automjeteve të pasiguruara

Në rast të dëmit të shkaktuar si pasojë e përdorimit të automjetit, ku pronari është dashur por nuk ka kontraktuar sigurimin e detyruar të autopërgjegjësise-, zhdëmtimi paguhet deri në të njëjtën shumë dhe sipas të njëjtave kushte sikur të ekzistonte sigurimi i detyrueshem i autopërgjegjësise.

Pas pagimit të dëmshpërblimit, mund të bëhet rimbursimi i shumës së paguar në bazë të kërkesës për regres nga pronari apo shfrytëzuesi i regjistruar i automjetit i cili nuk e ka siguruar automjetin, duke llogaritur këtu edhe kamatën me shpenzime.

4.7 Dëmet e shkaktuara nga përdorimi i automjeteve të paidentifikuara

Zhdëmtimi për çdo dëm në rast të vdekjes, lëndimit trupor apo dëmtimit të shëndetit të shkaktuar nga përdorimi i automjetit të paidentifikuar do të paguhet deri në shumën ku detyrimet e një kompanie të sigurimit në lidhje me dëmin e shkaktuar nga përdorimi i automjeteve limitohet sipas kësaj rregulle.

Nëse, pas pagimit të dëmit, identifikohet automjeti me përdorimin e të cilit është shkaktuar dëmi, rimbursimi bëhet me kërkesë regresi nga kompania e sigurimit me të cilën është kontraktuar sigurimi detyrueshem i autopërgjegjësise, duke llogaritur këtu edhe kamatën dhe shpenzimet.

4.8 Bankrotimi i Kompanisë Siguruese

Dëmi i shkaktuar si pasojë e përdorimit të automjetit për të cilin ëdhtë kontraktuar sigurimi i detyrueshem i autopergjegjesisë me kompani të sigurimit që ndodhet në proces falimentimi, do të kompensohet nga fondi garantues deri në masën e pazhdëmtuar nga pasuria e falimentimit.

4.9 Të drejtat e palës së dëmtuar

Pala e dëmtuar, të cilës dëmi i është shkaktuar me automjet dhe në rastet të cilat japin të drejtë për dëmshperblim në pajtim me nenin 4.1, ka të drejtë t'i parashtrijë kërkesë për zhdëmtim fondit garantues, që ka status të përsorit juridik.

BQK do t'ia besojë Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës organizimin edhe shërbimet adminstrativo-teknike të fondit garantues, ndërsa trajtimin e kërkesave për zhdëmtim organizatës së specializuar për trajtimin e dëmeve nga sigurimi i detyrueshem i autopergjegjesisë.

4.10 Të drejtat e regresit për te huajt, fondet pensionale dhe shëndetsore dhe kompanitë e sigurimit

Te huajt do të kenë të drejtën për kompezim të dëmit nga fondi garantues, nëse shteti të cilit i përkasin ua njeh të njëjtat te drejta si kosovareve për t'u zhdëmtuar me regres nga një fond i ngjashem garantues në vendin e tyre.

Fondet pensionale, invalidore dhe shëndetsore si dhe kompanitë siguruese që mirren me sigurimet (detyrimore apo vullnetare) pensionale e shëndetsore apo lloje të ngjashme të sigurimit të jetës, sigurimit shëndetsor e invalidor, sigurimit nga aksidentet dhe sigurimit aksidental të pasurisë, nuk kanë të drejtë në zhdëmtim apo regres nga fondi garantues.

Neni 5 Regullimi i dëmeve

5.1 Rregullimi

Kërkesat për zhdëmtim të bazuara në sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë në pajtim me dispozitat e kësaj rregulle,perfshire regresin nga fondi garantues duhet të zgjidhen në një periudhë kohore prej 10 ditësh prej ditës së parashtrimit të provave të nevojshme dhe dokumentacionit relevant që kërkohen nga kompania e sigurimit apo nga fondi garantues, duke iu referuar zhdëmtimit të dëmeve që kanë pasojë vdekjen, lëndime trupore apo humbjen e pasurisë.

Fondi Garantues apo nje kompani e sigurimit e cila nuk e rregullon dëmin valid brenda periudhës kohore prej dhjetë (10) ditësh, duhet të paguaj denimin e barabarte me 20% te kamatës vjetore te llogaritur nga data e raportimit të dëmit deri në datën kur zhdentimi është paguar apo rregulluar.

5.2 Format e raportimit të dëmeve

Kompanitë e sigurimit janë të obliguara të lëshojnë raporte evropiane mbi aksidentin se bashku me kërkesat e polisave të sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësisë.

Personat e përfshirë ne aksident të trafikut kanë për detyrim të plotësojnë, firmosin dhe të këmbëjnë formularin " Raporti Evropian për Aksidentin", nëse policia e trafikut apo ndonjë autoritet tjetër kompetent nuk ka bërë raport të aksidentit. Formulari i përmendur (i plotësuar drejt dhe i firmosur) mund të përdoret edhe si provë ne procedurën e trajtimit të dëmeve të sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësisë.

Neni 6 MASAT E NDËSHKIMORE

6.1 Ndëshkimet që rezultojnë në gjoba

Kompania e sigurimeve do të gjobitet në para prej 2,500 - 10,000 për shkak të këtyre kundërvajtjeve:

- a. Dështimi për të aplikuar kushtet dhe parimet e sigurimit te detyrueshëm të autopërgjegjësisë që janë prezentuar dhe aprovuar nga BQK-ja;
- b. Mospërmbushja e detyrimeve për të paguar kontributet për fondin garantues në pajtim me nenin 4 të kësaj rregulle dhe me rregulloret e UNMIK-ut.
- c. Dështimi i kontraktimit të sigurimit të detyruar, sipas nenit 1.3.
- d. Mosinformimi me anë të mediave për faktin se nuk është e gatshme për të ofruar sigurime me mbulesë plotësuese, në bazë të nenin 7.1 paragrafi 3 te kësaj rregulle dhe;
- e. Mosparaqitja e të dhënave statistikore dhe të tjera në mënyrë të specifikuar nga BQK.

Personi përgjegjës në kompaninë e sigurimeve do të gjobitet në para prej 500 deri 2,500 euro për shkak të kundërvajtjeve të specifikuara në paragrafin 1 të këtij neni.

6.2 Gjobat dhe dënimet ndaj pronarit te regjistruar automjetit

Pronari apo shfrytëzuesi i regjistruar i automjetit do të gjobitet në pajtim me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme nëse nuk kontraktin sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë para se të përdorë automjetin e tij në trafik.

Në rast se pronari apo shfrytëzuesi i regjistruar i automjetit motorik është person juridik, gjoba në të holla e përcaktuar me ligje dhe rregullore të aplikueshme duhet t'i imponohet personit juridik dhe/apo individëve

6.3 Ngasësi i automjeteve motorike

Ngasësi i automjetit do të gjobitet në para ne pajtim me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme nëse nuk posedon, përkatësisht nuk mund t'i prezentojë policisë së trafikut dëshmi për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjesisë ose formularin "Raporti evropian për aksidentin" kur policia e kërkon.

Neni 7

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

7.1 Sigurimet plotësuese

Kompanitë e sigurimit që kanë lëshuar sigurime të detyrueshme të autopërgjegjesisë, mbulesa e sigurise e te cilave vazhdon pasi të hyjë në fuqi kjo rregull, do t'i ofrojë të siguruarit një sigurim plotësues për periudhën e paskaduar te sigurimit në pajtim me kërkesat e kësaj rregulle.

Në të njëjtën kohë është obligim i pronarit të kompanisë dhe përdoruesve të regjistruar të automjeteve që të realizojnë sigurimin plotësues nga siguresit e tyre.

Nëse kompania e sigurimit nuk dëshiron t'i ofroje të siguruarit sigurimin plotësues te lartepërmendur, është e obliguar ta shpall këtë në media.

Neni 8

Standardet dhe struktura e llogaritjes se primeve për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia

8.1 Qëllimi i kësaj dispozite

Kompanitë e sigurimit të licencuara nga BQK në mënyrë të pavarur do ti përcaktojnë tarifën e primeve për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia. Me rastin e përcaktimit të tarifave duhet të i përmbahen standardeve, ashtuqë primet të jenë të drejta për të siguruarit, adekuate për kompanitë e sigurimit dhe jodiskriminuese në selektimin e rrezikut.

1. Primi i drejtë nënkupton që primi nuk duhet të jetë më i lartë se sa policembajtesi mbulohet me police sigurimi.
2. Primi adekuatë nënkupton që primi i përcaktuar të jetë i mjaftueshëm për të mbuluar humbjet dhe shpenzimet e sigurveesit, ashtu që niveli i primit të ofroi siguri dhe mbrojtje adekuate për policembajtesit dhe palëve të treta të dëmtuar.
3. Primi jo diskriminues nënkupton që në rast ekspozimi ndaj rreziqeve të njëjta, në kuptim të humbjeve dhe shpenzimeve, nuk duhet të përcaktuar prime të ndryshme.

8.2 Struktura e kalkulimit të primit

Baza për kalkulimin e primit për sigurimin e detyrueshëm duhet të jetë risku sigurvees, bazuar në dispozitat ligjore të Leshuara nga BQK-ja.

Kompanitë e sigurimit përcaktojnë primet neto dhe bruto duke u bazuar në riskun sigurvees, kushtet e përgjithshme të polices, bazat teknike të shfrytëzuara me rastin e kalkulimit të primi, si dhe vlerësimin aktuaristik të primit nga ana e aktuarit të certifikuar.

8.3 Aprovimi i primit për sigurimin e detyrueshëm nga BQK

Primi i sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia i propozuar nga kompania e sigurimit do të i nënshtrohet aprovimit paraprak të BQK.

Me rastin e aplikimit për aprovimin e primit të sigurimit në BQK, kompania e sigurimit duhet të dorëzoj :

- a) kushtet e përgjithshme të polices,
- b) bazat teknike të shfrytëzuara me rastin e kalkulimit të primit dhe
- c) bazat e kalkulimit aktuaristik të primit me të shkurtër prej tre viteve.

Kompanitë e sigurimit kanë të drejtë të aplikojnë me se shumti dy here gjatë një viti për ndryshimin e primeve, në dhjetor dhe qershor. BQK brenda 30 ditësh do të vendos për aprovimin apo jo të tarifave të primeve TPL.

Neni 9 Hyrja në fuqi

Ky Rregull hyn në fuqi më 1 tetor 2008.

Hashim Rexhepi
Guvernator

